MIRATOHET
SEKRETARI I K.K.T.K.M-së
ARTA DOLLANI

# RELACION TEKNIK

## PROJEKT RESTAURIMI URA E GLINËS NË FSHATIN GRAPSH, DROPULL I POSHTËM

Llambrino Baballeku
Digitally signed by Llambrino Baballeku
Date: 2021.02.02 12:01:10 +02'00'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Tirane 2021

## VENDODHJA

Ura e Glinës ndodhet në fshatin Grapsh në Dropullin e Poshtëm, pranë rrugës nacionale Gjirokastër-Janinë. Ura e Glinës përdorej për të lidhur fshatin e Grapshit me fshatërat e Peshkëpisë dhe Glinës. Tani kjo urë nuk përdoret pasi pranë saj ndodhet një urë automobilistike e cila lidhë rrugën nacionale me fshtatërat e Glinës dhe Peshkopisë e cila plotëson nevojat e banorëve.




Foto.1 PAMJE AJRORE E FSHATIT GRAPSH DHE E URES SE GLINES




Foto 2. ORTOFOTO E URES SE GLINES

## PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK

Në afërsi të fshatit Grapsh,ngjitur me rrugën nacionale ndodhet një urë guri me katër hapësira.Nëpër këtë urë kalon rruga për në fshatin Glinë,prandaj dhe ura merr emrin ura e Glinës.Është ndërtuar mbi degën e lumit Drinos,që vendasit e flasin si "lumi I thatë". Kjo urë përmendet që në vitin 1897,si lidhëse midis Peshkëpisë dhe Grapshit. Ura ka kater këmbë Harqet e urës janë të trajtuar në formë lundre me gurë të skuadruara.Janë me hapësira të ndryshme,variojnë nga 5 deri në 7,2 m dhe me nje gjerësi maksimale 2.5m. Ura është e shtruar me kalldrëm me gurë të vendosir këllic mbi shtresen e rërës e cila ne disa pjesë afër bordurave të urës ka cedim kalldrëmi dhe ne disa raste ky kalldrëm mungon. Ura është e ndërtuar me gurë gëlqeror i skuadruar ne dy pjesët e shpatullave të urës. Ura paraqitet në një gjendje të mirë relativisht stukturore ku problematikë shfaqet në pjesët e këmbëve të para të urës, ku vërehet mungesë e materialit lidhës dhe ne disa raste kemi disa carje në carëset e urës të cilat janë

pasqyruar në projekt.Nje problematikë të cilën ky objekt ka është prezenca e lartë e gjelbërimit përgjatë monumentit dhe vegjetacionit në trupin e urës.  Tani kjo urë nuk përdoret pasi pranë saj ndodhet një urë automobilistike e cila lidh rrugën nacionale me fshtatërat e Glinës dhe Peshkopisë e cila plotëson nevojat e banorëve.

## FOTO NGA ARKIVI I IKTK-së



Foto3. FOTO NGA ARKIVI I IKTK-së

# PLNI I RILEVIMIT TE URËS SË GLINËS




Foto 4. RIVELIMI I PANIT TË URËS DHE FASADËS SË SAJ

## GEN PALNI I URËS SË GLINËS




Foto 5. GEN PLANI I URËS

## DOKUMENTIMI FOTOGRAFIK

FOTO NGA BJEFI I SIPËRM



FOTO NGA BJEFI I POSHTËM



FOTO NGA KALLDREMI I URËS



Foto 6. FOTO TË GJENDJES EKZISTUESE

Ura është e shtruar me kalldrëm me gurë të vendosir këllic mbi shtresen e rërës e cila në disa pjesë afër bordurave të urës ka cedim të kalldrëmit dhe ne disa raste ky kalldrëm mungon.Nje problematikë të cilën ky objekt paraqet është prezenca e lartë e gjelbërimit përgjatë monumentit

dhe vegjetacionit në trupin e urës. Pjesa më e madhe e kalldrëmit është e mbuluar me vegjetacion. Pikërisht dhe prezenca e madhe e gjelbërimit ka sjellë pamundësine e evidentimit te problematikave.

## PROBLEMATIKA NË FOTO







Foto 7. FOTO TE CARËSVE TE UJIT

Ura paraqitet në një gjendje të mirë relativisht stukturore ku problematikë shfaqet në pjesët e këmbëve të para të urës. Në pjesët poshtme të carësve ujit vërehet mungesë e materialit lidhës si pasojë e vërshimit të ujit të lumit. Në foto paraqiten disa carje të cilat janë evidentuar me ngjurë të kuqe.

## NDËRHYRJET E PROPOZUARA

1. Pastrim mekanik nga bimesia e larte ne dy skajet e ures dhe me pas te realizohet tharrja e rrenjeve masive(raundap 200cc)pasi te realizohet pastrmi nga bimesia te behet kontrolli mbi gjendjen e struktures se ures dhe do te vleresohet nga grupi i projektimit.

2. Pas pastrimit te vegjetacionit do te behet kontrolli per cedimin e shtreses se kalldremit. Ne pjesen ku mungon kalldremi dhe ne pjesen ku kalldremi eshte i demtuar do te realizohet kalldremi me gureve grlqeror te vendosur kellic mbi shtresen e reres.

3. Realizim i shtresave dhe rivendosje kellic e gureve gelqeror te kalldremit mbi shtresene e reres e cila do te hidhet dhe nga siper per te mbushur fugat ndermjet gureve.

4. Restaurim i bordurave me gure gelqeror dhe me te njetin dimesion te cilat do te fiksohen me llac-gelqere hidraulike

5. Pastrim nga bimësia e ulët ne pjesen e kalldremit te ures dhe nga fasadat e saj, me pas te realizohet dhe injektim i solucionit per tharjen e bimeve te keqija.

6. Pasi te realizohet pastrim nga depozitimet e dherave dhe mbeturinave do te behet kontrolli dhe vlersimi mbi gjendjen e struktures se ures dhe do te vleresohet nga grupi i projektimit per nderhyrjet.

7. Restaurimi i ketyre carjeve do te realizohet me ane te injektimit te materialit lidhes i cili do te injektohet ne gjithe pjesen e poshtme te caresve te ujit.




Foto 8. PLANIMETRIA E URES KU PARAQITEN DEGRADIMET DHE NDERHYRJET




Foto 9. PAMJET E URES KU PARAQITEN DEGRADIMET DHE NDERHYRJET

**LEGJENDA**

DEGRADIME/ NDËRHYRJE

**PREZENCE E LARTE VEGJETACIONI**/PASTRIM MEKANIK NGA BIMËSIA E LARTË NË DY SKAJET E URËS DHE MË PAS TË REALIZOHET THARRJA E RRËNJËVE MASIVE(RAUNDAP 200CC) PASI TË REALIZOHET PASTRMI NGA BIMËSIA TË BËHET KONTROLLI MBI GJËNDJEN E STRUKTURËS SË URËS DHE DO TË VLERËSOHET NGA GRUPI I PROJEKTIMIT

**PATINË BIOLOGJIKE DHE PREZENC Ë VEGJETACIONI**/ PASTRIM NGA BIMËSIA E ULËT NË PJESËN E KALLDRËMIT TË URËS DHE NGA FASADAT E SAJ, MË PAS TË REALIZOHET DHE INJEKTIM I SOLUCIONIT PËR THARJEN E BIMËVE TË KËQIJA

**DËMTIM I BORDURAVE DHE MUNGESË MATERIALIT LIDHËS**/ RESTAURIMIN DHE VENDOSJEN E GURËVE TË BORDURËS SË URËS TË CILËT JANË TË DËMTUAR, PLOTËSIMI I TYRE ME GURË TË NGJAJSHËM NË PËRMASA DHE PËRBERJE ME ATA EKZISTUES, GURET DO TE FIKSOHEN ME MATERIAL LIDHËS LLAC-GELQERE HIDRAULIKE.

**MUNGESË E SHTRESËS SË KALLDRËMIT**/ PAS PASTRIMIT TË VEGJETACIONIT DO TË BËHET KONTROLLI PËR PJESËN NË TË CILËN VËREHET CEDIMI I SHTRESËS SË KALLDRËMIT, PËR PJESËN KU MUNGON KALLDRËMI DHE PËR PJESËN KU KALLDRËMI ËSHTË I DËMTUAR DO TË REALIZOHET KALLDRËM ME GURË GRLQEROR TË VENDOSUR KËLLIC MBI SHTRESËN E RËRËS

**DEPOZITIM I DHERAVE**/ PASI TË REALIZOHET PASTRIM NGA DEPOZITIMET E DHERAVE DHE MBETURINAVE DO TË BËHET KONTROLLI MBI GJËNDJEN E STRUKTURËS SË URËS DHE DO TË VLERESOHET NGA GRUPI I PROJEKTIMIT

SONDAZH NË ZONAT E PËRCAKTUAR NË PLAN PËR TË EVIDENTUAR GJURMËT E STRUKTURËS DHE PËR TË VERIFIKUAR THELLËSINË DHE GJENDJEN E THEMELEVE

**CEDIMI I SHTRESËS ME KALLDRËM**/ REALIZIMI I SHTRESAVE DHE RIVENDOSJE KËLLIC E GURËVE GËLQEROR TË KALLDRËMIT MBI SHTRESËN E RËRËS E CILA DO TË HIDHET DHE NGA SIPER PËR TË MBUSHUR FUGAT NDËRMJET GURËVE

**CARJE E MURATURËS NË PJESËN E POSHTME TË CARËSVE TË UJIT SI PASOJË E VËRSHIMIT TË UJËRAVE I CILI KA SJELLË DHE DËMTIMIN E MATERIALIT LIDHËS** / RESTAURIMI I KËTYRE CARJEVE DO TË REALIZOHET ME ANË TËE INJEKTIMIT TE MATERIALIT LIDHËS I CILI DO TË INJEKTOHET NË GJITHË PJESËN E POSHTME TË CARESVE TË UJIT.

VENDOSJA E NJË PANELI INFORMUES MBI MONUMENTIN. PANELI DO TË VENDOSET NË POZICIONIN E PARAQITUR NË PROJEKT ME DIMESION 90X60CM

**Përgatiti Grupi i punës:**

Ark. Arta Dollani

Ark. Daniel Pirushi

Ing. Denisa Shehu

Ing. Endrita Mulleti

Ark. Llambrino Baballëku

Ark. Rudina Papavasili

Ark. Artila Vavako

Ark. Joli Mitrojorgji

Artila Vavako — Digitally signed by Artila Vavako Date: 2021.02.08 01:45:21 +02'00'

Denisa Shehu — Digitally signed by Denisa Shehu Date: 2021.02.09 09:40:42 +02'00'

Daniel Pirushi — Digitally signed by Daniel Pirushi Date: 2021.02.09 09:43:07 +02'00'

Joli Mitrojorgji — Digitally signed by Joli Mitrojorgji Date: 2021.02.09 10:37:21 +02'00'

Arta Dollani — Digitally signed by Arta Dollani Date: 2021.02.10 03:12:26 +02'00'

Rudina Papavasili — Digitally signed by Rudina Papavasili Date: 2021.02.11 10:28:59 +02'00'

Endrita Mulleti — Digitally signed by Endrita Mulleti Date: 2021.02.11 03:25:19 +02'00'